

LIGJ
Nr. 28/2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 125/2013,
“PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 5, shkronja “i” ndryshohet si më poshtë:

“i) për ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, përveç hidrocentraleve.”.

Neni 2

Në nenin 17, shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) operatorët ekonomikë nëpërmjet propozimeve të pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në: porte, aeroporte, energjinë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, me përjashtim të prodhimit e shpërndarjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike.”.

Neni 3

Në nenin 18, pika 5, shkronja “a” riformulohet si më poshtë:

a) harton raportin përmbledhës, mbi bazën e të cilit autoriteti merr vendimin për shtyrjen, refuzimin e plotë ose vazhdimin e procedurave, si dhe harton studimin e fizibilitetit për koncesionin/partneritetin publik privat, përcakton procedurën e zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat dhe harton dokumentacionin e tenderit.”.

Neni 4

Në nenin 19, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Studimi i fizibilitetit për koncesionin/partneritetin publik privat hartohet nga komisioni i dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat, brenda 60 ditëve pune nga vendimi i autoritetit kontraktues për vazhdimin e procedurave. Ky afat mund të shtyhet për shkaqe të kompleksitetit të projektit me jo më shumë se 30 ditë pune.”.

Neni 5

Në nenin 25, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Autoriteti kontraktues autorizohet të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose shërbimeve në: porte, aeroporte, energjinë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, me përjashtim të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike, në përputhje me procedurat e përcaktuara në

këtë nen, me kusht që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt për të cilin procedurat e përzgjedhjes kanë nisur apo janë shpallur.”.

Neni 6

Në nenin 28, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Para nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentet e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncesionarëve/partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj.)”.

b) Pas pikës 1, shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 si më poshtë:

“1/1 Sigurimi i kontratës koncesion i shërbimeve publike do të jetë deri në 5% të vlerës së kontratës. Kjo masë mund të reduktohet në mënyrë përpjesëtimore gjatë ekzekutimit të kontratës, por në asnjë rast gjatë kohëzgjatjes së saj nuk mund të jetë më e vogël se 25% e vlerës fillestare të sigurimit.

1/2 Sigurimi i kontratës koncesion i punëve publike do të jetë deri në 5% të vlerës së ndërtimit, ndërsa pas periudhës së ndërtimit do të jetë deri në 5% të vlerës së mbetur të kontratës.”.

Neni 7

Dispozitë kalimtare

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për veprimet dhe procedurat për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, por nuk zbatohen për kontratat e koncesionit të nënshkruara para hyrjes në fuqi të tij.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.4.2024.

Shpallur me dekretin nr. 159, datë 24.4.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.